33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin e impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e shih të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-24-629-5-2-1/C1423

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit ekzekutimit është 10% i vlerës totale te kontrates ne afat prej 150 ditesh.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës..
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Planin dinamik i punëve (minimum 60 ditë dhe maksimum 120 ditë)
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës me vendim nga ZKA
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga 50.000 € për punët e kryera dhe te konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve 3 vite .
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Garancioni i punimeve max. 10 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara. Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme. Nëse me fajin e OE vjen deri te shkëputja e kontratës atëherë me marrëveshje te palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe

		<p>pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhen mjete nga Komuna e Prishtinës për punët e pakryera dhe llogariten demet e shkaktuara për moskryerjen dhe zhegjitjen e punimeve që i paguan pune kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale të kontratës në Komunen e Prishtinës</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<p>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</p>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) <i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</i></p> <p>ose</p> <p>b) <i>kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</i></p> <p><i>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</i></p>

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2, -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 616-24-629-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik HARST Group SH.P.K.; DACHGroup SH.P.K., Harstgroup, 23000, Suharekë, Kosovë**

E-mail: **info@harstgroup.eu**

Personi kontaktues: **Sadik Ramadani**

Telefoni: **049/460512**

Faxi: **N/A**

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **HARST Group SH.P.K.**

Numri fiskal: **810025090**

Vend-Selia: **Harstgroup, 23000, Suharekë, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **DACHGroup SH.P.K.**

Numri fiskal: **811460617**

Vend-Selia: **Lakrishte, rr. Tirana, H.C, kati 5 S1, 10000, Prishtine, Kosovë**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-24-629-5-2-1

Titulli i kontratës: Rikonstruimi i hapsirave publike në rrugën Egnatia ,lagja Ulpiana - Prishtinë

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Rikonstruimi i hapsirave publike në rrugën Egnatia ,lagja Ulpiana -Prishtinë

3. Çmimi total i tenderit është:

182,326.60 EUR

Dhe në fjalë *shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro*

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Nr.	Nën-kriteri	Koeficient	Përgjigje EO
1	Çmimi më i ulët i ofertës = 60%	0.60	182,326.60 EURO
2	Garancinë e punimeve min. 5 vite=0% Garancinë e punimeve max. 10 vite=30%	0.30	10 Vite
3	Plani dinamik max. 120 ditë = 0% Plani dinamik min. 60 ditë =10%	0.10	60 Dite

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Rikonstruktimi i hapësirës publike në rrugën "Ignacia" lagja "Ulpiana" Prishtinë


Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO.

Masat e sigurisë. Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtës dhe vendosjes e materialeve në të si dhe të mirën masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësirës në mes të zonës nën ndërtim (RENOVIM) dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtës. Për rrethojën të rrethohet me rrejtë metalike nga teli me diametër 2.3mm apo armaturë rrejtë me katrorë 20/20 cm dhe me konstruksion të përfortuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashit edhe ckyqjen e instalimeve ekzistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rrisqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve. Përshkrimi i punëve në përputhshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO.


Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO. Gjate fazës së ofertimit duhet të ofrohen/propozohen të gjitha materialet/pozicionet e propozuara me standardet e krijuara dhe performanca teknike. Materialet duhet të jenë të certifikuar për shfrytëzim publik bazuar në standardet e EU dhe të kenë qëndrueshmëri afatgjatë. Në prezantim të ofrimit tekniko, aty ku është e aplikueshme, duhet të prezantohet brendi dhe modeli i propozuar i materialeve në bazë të kërkesës.

VËMBËNDJE: Të gjitha materialet e përdorura dhe të ekzekutuara duhet të dëshmohen me ateste.


Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi €	Gjithsej €
1	Punët e Përgatitjes së punishtës				
1.1	Inçizimi gjeodezik i lokacionit (terenit), si dhe realizimi i projektit në bazë të pikave gjeodezike të vendosura në projekt.	m ²	1975	1.70	3,357.50 €
1.2	Furnizimi me material dhe vendosja e dy pllakatave me informacione relevante për projektin; Plakati 1 me dim 100/150 cm ku duhet të shenohet: Emri i Autoritetit Kontraktues (Investitorit), Emrin e projektit, Numrin e lejes së ndërtimit, Emrin e vendndërtimit, Emrin e Kontraktorit. Plakati 2 me dim 80/120 cm e njëjtueshme për përmbajtjen e shënimeve apo të dhënave për sa i përket me shënimet e nevojshme për lajmërimin së është vendndërtim, me shënimet e dulura për shenjat e paralajmërimit dhe shenjat e rrezikut! Duke specifikuar edhe masat mbrojtëse dhe paisjet e nevojshme për vendin e ndërtimit!	copë	1	1.800.00	1,800.00 €
1.3	Pastrimi i terrenit nga materialet e ndryshme: vazo të betonit, shadervani, rrethojat nga konstruksioni i qelikut me rrejtë të armatures, rrethojë nga druri, ulëset, shkurret, drunjtë të caktuar të (konsultohet nga organi mbikqyrës) dhe elementet tjera të cilat gjenden në hapësirën ku do të punohet. Transporti deri në deponi legale min 15km, të caktuar nga organi mbikqyrës.	komplet	1	800.00	800.00 €
1.4	Masat mbrojtëse dhe përcjellëse për mbrojtjen e ambientit rrethues, nga zjarri dhe dëmtimet eventuale të gjelbërimit.	komplet	1	120.00	120.00 €
1.5	Shkyqja e përkohëshme, kontrollimi dhe e videntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detaj operativ që lidhet me procesin e ndërtimit.	komplet	1	235.00	235.00 €
1.6	Sigurimi i punishtës, rrethimi me rrejtë metalike nga teli me diametër 2-3mm apo armaturë rrejtë me katrorë 20/20 cm, ime konstruksion të përfortuar mirë në tokë. Ky rrethim duhet të bëhet nga anët e hyrjeve anësore të automjeteve dhe njerëzve, gjithashtu të bëhet edhe vendosja e sinjalizuesve (shenjave) të cilat tregojnë se janë duke u zhvilluar punime në punishten përkatëse, të cilat krijojnë siguri dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave të investitorit. Duhet të bëhet edhe vendosja e tabelës informuese në punishtë.	m'	75	45.00	3,375.00 €
1.7	Instalimi i zyrës së përkohëshme në punishtë (~12m ²).	komplet	1	250.00	250.00 €
1.8	Instalimi i përkohshëm i instalimeve komunale (uji, mbeturinat, rryma me njëhisor- nga rrjeti, gjeneratori).	komplet	1	250.00	250.00 €
1.9	Furnizimi i materialit, punimet dhe preventivi i konservimit të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas ndërtimit të objektit.	komplet	1	1,000.00	1,000.00 €
1.10	Ndërtimi i WC-së së përkohëshme, gjatë kohës së zhvillimit të punimit - ndërtimit në hapësirë deri në përfundim të saj.	copë	1	150.00	150.00 €
1.11	Pas përfundimit të punimeve të gjitha materialet e krijuara nga punimet e përfunduara duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i hapësirës së terrenit. Transporti të bëhet në deponi legale, të caktuar nga organi mbikqyrës në distancë min 15km.	komplet	1	500.00	500.00 €
				Total:	11,837.50 €
2	Demolimet				
2.1	Demolimi i /përsishëm i dyshemesë ekzistuese nga materialet: beton, kubëza betoni, qeramike, gurë të gllarëvës, skajore, cokëll betoni, zhanor, asfalti, rrethoja (dru, profile metalike, fije armature), shadërvan, streha nga konstruksioni i drurit me tegolla, shitresa e sipërme e shkallëve si dhe bartja deri në deponinë legale, të caktuar nga organi mbikqyrës në distancë min 15km.	m ²	1850	0.80	1,480.00 €
				Total:	1,480.00 €




Punët Ndërtimore						
3	VËMENDJE: Egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër të tyre si p.sh tamponit, kubëzave nga betoni, skajoreve dhe elementeve tjera për shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë: Certifikatat nga prodhuesi për materialet që ka ndërmend të furnizon për të përmbushur kontratën! Fletën teknike të materialeve nga prodhuesit! Certifikatën e performancës nga Prodhuesi. Atestet e magjtraleve nga Prodhuesi. Mostrat e materialeve. Mostra të materialeve për testime laboratorike para aprovimit të materialeve.					
3.1	Gërmimi i gjërë I dheut në thellësi prej 50cm, me makineri adekuate, në hapësirën ku do të punohet. Ngarkimi dhe transporti deri në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton organi mbikqyrës në distancë min 15km.	m ²	940	2.00	1,880.00 €	
3.2	Planifikimi dhe nivelizimi i nënbazës në pjesën e hapësirës ku do të punohet, si dhe ngjeshja e saj me cilindër ose me mjete më të vogla adekuate për ngjeshje, të kërkuar sipas normave dhe standardeve M ₁₂ 300 kg/cm ²	m ²	1886	9.00	16,974.00 €	
3.3	Furnizimi, transporti me material si dhe shtruarja e gjeotekstilit sipas projektit, 300gr/m ² në nënbazën e dheut të nivelizuar dhe ngritur.	m ²	2110	0.60	1,266.00 €	
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së rrërs - me fraksion 0-4 mm, me trashësi t=5cm (në gjendje të ngritur) në pjesët ku do të punohet dyshemeja, për mbulimin e gjeotekstilit, me CBR>20%, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues ose mjete më të vogla për ngjeshje deri në masë të densitetit të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M ₁₂ 500 kg/cm ²).	m ³	111	6.00	666.00 €	
3.5	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 4-8mm, me trashësi t=5cm, me CBR>20% duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues ose mjete më të vogla për ngjeshje deri në masë të densitetit të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M ₁₂ 500 kg/cm ²).	m ³	106	6.00	636.00 €	
3.6	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi sipas projektit, sipas projektit t=20cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues ose mjet me të vogël për ngjeshje deri në masë densitetit të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M ₁₂ 500 kg/cm ²).	m ³	413.5	6.00	2,481.00 €	
3.7	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror sipas projektit, 0-31.5mm me trashësi t=10cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues ose mjet më të vogël për ngjeshje deri në masë densitetit të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M ₁₂ 700 kg/cm ²).	m ³	212	6.00	1,272.00 €	
3.8	Furnizimi dhe vendosja e skajoreve të betonit MB 40 me dimensione 8/20/100 cm të vendosura në bazën e betonit MB20. Pjesa e sipërme e skajores (e dukshme) të jetë e impregnuar dhe e zallusur, e punuar nga kuarci me trashësi t=10mm, ngjyra caktohet nga organi mbikqyrës. Në çmim duhet të llogariten: skajoret, betoni, aditivet hidrostop apo të ngjashëm. Skajoret duhet të kenë këto specifika: rezistencë ndaj përkuqjes, tërheqjes, abrazionit, absorbimit të ujit, rezistencën ndaj ngricave etj, sipas standardeve EN1340. Atestet duhet të bëhen në prezencën e organit mbikqyrës.	m ²	645	15.00	9,675.00 €	
3.9	Furnizimi dhe montimi i kubëzave dyshtrësore të betonit MB 40 me dimensione 10x10x10cm. - Shtresa e parë duhet të jetë nga betoni i presuar ndërsa, - Shtresa e dytë duhet të jetë nga materialet e grimeuara si Graniti, Kuarci, Diabazi, etj me trashësi 10-20mm (trashësia duhet të jetë në vlera referuese të Standardeve Evropiane EN 13748-2, kubëza për përdorim në hapësira të hapura në ambiente të jashtme). Duhet të jetë e zallusur dhe e impregnuar (rezistente nga lagështia dhe njollat). Kubëzat duhet të jenë të kualifikuara dhe të pranuar si material, duke poseduar shenjën CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 për kubëza, EC (Deklaration of Conformity). Ngjyra e kubëzave duhet të jetë antracit. Pas montimit të kubëzave bëhet vendosja shtresën e rrërs (Fugës) dhe të bëhet ngjeshja e vibrator në mënyrë që kubëzat e dëmtuara të ndërrohen. Kubëzat për përdorim të jashtëm duhet të plotësojnë: - Rezistenca ndaj përkuqjes - Rezistenca ndaj ngricave me standard të ngjashëm të EU - Absorbimi i ujit nga kapilarët - Rezistenca ndaj rrëshqitjes (USRV) - Rezistenca ndaj gërryerjes (kategoria 3) Vërejtje: Të gjitha pikat e shënuara më lartë të dëshmohen me ateste të veqanta të standardeve DIN ose të EU-së. Ngjyra e kubëzave duhet të jetë antracit. Pas montimit të kubëzave të bëhet vendosja e shtresës së rrërs (Fugës) dhe ngjeshja me vibrator në mënyrë që kubëzat e dëmtuara të ndërrohen.	m ²	438	33.00	14,454.00 €	




3.10	<p>Furnizimi dhe montimi i kubëzave dyshtresore të betonit MB 40 me dimensione 10x10x10cm.</p> <p>- Shtresa e parë është nga betoni i presuar ndërsa,</p> <p>- Shtresa e dytë nga materialet e grincuara si Graniti, Kuarci, Diabazi, etj me trashësi 10-20mm (trashësia duhet të jetë në vlera referuese të Standardeve Evropiane EN 13748-2, kubëza për përdorim në hapësira të hapura në ambiente të jashtme). Kjo shtresë duhet të jetë e zallësuar dhe e impregnuar (rezistente nga lagështia dhe njollat). Kubëzat duhet të jenë të kualifikuara dhe të pranuar si material, duke poseduar shenjë CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 për kubëza, EC (Deklaratën e Konformitetit).</p> <p>Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë), sistemi hermetik i makinerisë prodhuese. Kubëzat për përdorim të jashtëm duhet të plotësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezistenca ndaj përkuljes - Rezistenca ndaj ngricave me standard të ngjashëm të EU - Absorbimi i ujit nga kapilarët - Rezistenca ndaj rrëshqitjes (USRV) - Rezistenca ndaj gërryerjes (kategoria 3) <p>Vërejtje: Të gjitha pikat e shënuara më lartë të dëshmoohen me ateste të veqanta të standardeve DIN ose të EU-së.</p> <p>Ngjyra e kubëzave duhet të jetë hiri.</p> <p>Pas montimit të kubëzave të bëhet vendosja e shtresës së rërës (Fugës) dhe ngjeshja me vibrator në mënyrë që kubëzat e dëmtuara të ndërrohen.</p>	m ²	210	33.00	6,930.00 €
3.11	<p>Furnizimi dhe montimi i kubëzave dyshtresore të betonit MB 40 me dimensione 25x50x10cm.</p> <p>- Shtresa e parë është nga betoni i presuar ndërsa, Shtresa e dytë nga materialet e grincuara si Graniti, Kuarci, Diabazi, etj me trashësi 10-20mm (trashësia duhet të jetë në vlera referuese të Standardeve Evropiane EN 13748-2, kubëza për përdorim në hapësira të hapura në ambiente të jashtme). Kjo shtresë duhet të jetë e zallësuar dhe e impregnuar (rezistente nga lagështia dhe njollat). Kubëzat duhet të jenë të kualifikuara dhe të pranuar si material, duke poseduar shenjë CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 për kubëza, EC (Deklaratën e Konformitetit).</p> <p>Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë), sistemi hermetik i makinerisë prodhuese.</p> <p>Kubëzat për përdorim të jashtëm duhet të plotësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezistenca ndaj përkuljes - Rezistenca ndaj ngricave me standard të ngjashëm të EU - Absorbimi i ujit nga kapilarët - Rezistenca ndaj rrëshqitjes (USRV) - Rezistenca ndaj gërryerjes (kategoria 3) <p>Vërejtje: Të gjitha pikat e shënuara më lartë të dëshmoohen me ateste të veqanta të standardeve DIN ose të EU-së.</p> <p>Ngjyra e kubëzave duhet të jetë hiri.</p> <p>Pas montimit të kubëzave të bëhet vendosja e shtresës së rërës (Fugës) dhe ngjeshja e vibrator në mënyrë që kubëzat e dëmtuara të ndërrohen.</p>	m ²	43.00	33.00	1,419.00 €
3.12	<p>Furnizimi dhe montimi i kubëzave dyshtresore të betonit MB 40 me dimensione 50x75x10cm.</p> <p>- Shtresa e parë është nga betoni i presuar ndërsa,</p> <p>- shtresa e dytë nga materialet e grincuara si Graniti, Kuarci, Diabazi, etj me trashësi 10-20mm (trashësia duhet të jetë në vlera referuese të Standardeve Evropiane EN 13748-2, kubëza për përdorim në hapësira të hapura në ambiente të jashtme). Kjo shtresë duhet të jetë e zallësuar dhe e impregnuar (rezistente nga lagështia dhe njollat). Kubëzat duhet të jenë të kualifikuara dhe të pranuar si material, duke poseduar shenjë CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 për kubëza, EC (Deklaratën e Konformitetit). Montimi i kubëzave bëhet mbi shtresën e rërës me fraksion 4mm, 1-50mm.</p> <p>Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi për menaxhimin e cilësisë), sistemi hermetik i makinerisë prodhuese.</p> <p>Kubëzat për përdorim të jashtëm duhet të plotësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezistenca ndaj përkuljes - Rezistenca ndaj ngricave me standard të ngjashëm të EU - Absorbimi i ujit nga kapilarët - Rezistenca ndaj rrëshqitjes (USRV) - Rezistenca ndaj gërryerjes (kategoria 3) <p>Vërejtje: Të gjitha pikat e shënuara më lartë të dëshmoohen me ateste të veqanta të standardeve DIN ose të EU-së. Ngjyra e kubëzave duhet të jetë hiri.</p> <p>Pas montimit të kubëzave të bëhet vendosja e shtresës së rërës (Fugës) dhe ngjeshja me vibrator në mënyrë që kubëzat e dëmtuara të ndërrohen.</p>	m ²	928.00	32.00	29,696.00 €
3.13	<p>Furnizimi me material dhe mbushja e fugave me material travertine për përdorim të jashtëm me efekt drenues duke mos lejuar rritjen e barit dhe duke përfunduar pilakën me njëra tjetrën. Gjerësia e fugës duhet të jetë 3mm. Sasia e materialit të fugës është 1.0 kg/m². Në pozicion të parashihet edhe ngjeshja e fugave përmes cilindrit vibrues dhe heqja e kubëzave të dëmtuara gjatë ngjeshjes dhe zvendosimi i tyre me të reja.</p>	kg	1763	0.90	1,586.70 €
3.14	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i mureve mbrojtëse - nga betoni i armuar me klasë të betonit C-25/30, me trashësi 20cm.</p> <p>Në pozicion të parashihet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - betonimi i themellit nga betoni i armuar me dimension: gjëresë 50cm dhe thellësi 60cm, - armimi i murit (80kg/m²) - vendosja e kallupeve me të gjitha elementet e nevojshme deri në vendosjen e betonit si dhe heqja e kallupeve pas ngurtësimit të betonit. <p>Të gjitha punimet duhet të kryhen konform rregullave për këtë pozicion dhe sipas udhëzimeve nga organi mbikqyrës.</p>	m ³	4.60	150.00	690.00 €




